



Komisioni Evropian

Të kuptuarit e Zgjerimit

Politika e zgjerimit e Bashkimit Evropian





*Olli Rehn
Anëtar i Komisionit Evropian
përgjegjës për zgjerim*

Gatë gjysmë shekulli, Bashkimi Evropian ka ndjekur integrimin më të thellë ndonjëherë gjatë pranimit të anëtarëve të rinj. Në të shumtën e kohës, dy proceset janë zhvilluar paralelisht. Si rrjedhojë, BE e sotshme, me 27 shtete anëtare dhe me popullatë prej afro 500 milionë banorë, është më e sigurt, më prosperuese, më e fuqishme dhe me më shumë ndikim se sa Komuniteti Ekonomik Evropian i para 50 viteve, me 6 anëtarë të tij dhe popullatë prej më pak se 200 milionë.

Anëtarësimi i rritur ka qenë pjesë e zhvillimit të integritimit Evropian qysh nga fillimi. Debati lidhur me zgjerimin është po aq i vjetër sa edhe vetë BE-ja. Sa herë që BE-ja pranon anëtarë të rinj, ai ndryshon. Kur mendojmë se çfarë mund të bëhemi na detyron të mendojmë për atë se çfarë jemi tani, dhe çfarë dëshirojmë të bëhemi në të ardhmen.


Qeveritë e zgjedhura në mënyrë demokratike të shteteve anëtare të BE-së, duke ardhur së bashku në Këshillin Evropian, janë pajtuar që zgjerimet e ardhshme do të kenë të bëjnë me vendet të cilat tani janë duke punuar në drejtim të anëtarësimit në BE - Kroacia, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Serbia,

Kosova (nën Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të KB), dhe Turqia. Anëtarësimi do të ndodhë vetëm atëherë kur secili vend i përmbush kërkesat e domosdoshme. Një proces i zgjerimit gradual dhe i menaxhuar me kujdes krijon një situatë fitues-fitues për të gjitha vendet në fjalë.

Qëllimi i kësaj broshure është që të shpjegohet, në një mënyrë të qartë dhe koncize, se çfarë është politika e zgjerimit të BE-së, dhe si zbatohet në praktikë. Ajo synon që lexuesit t'i jap një pasqyrë se si është rritur BE-ja që nga themelimi, ku qëndron sot pasi që ka kaluar raundin e tij më të rëndësishëm të zgjerimit në 2004/2007, dhe çfarë është perspektiva e pranimit të anëtarëve të rinj në të ardhmen. Mbi të gjitha, ky publikim synon t'iu përgjigjet pyetjeve më të shpeshta si "Kush vendos?", dhe "Si bëhet një aspirues shtet anëtar?"

Zgjerimi në 2004/2007 në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore, dhe në Mesdhe është dëshmuar si sukses i madh për BE-në, edhe pse ai është përdorur si viktimitë e problemeve të shumta sociale dhe ekonomike në Evropë. Në fakt, ky raund i fundit i zgjerimit e ka rritur zonën e paqes, stabilitetit dhe demokracisë në kontinentin tonë, dhe e ka fuqizuar ekonominë evropiane duke i zgjeruar tregjet, duke krijuar mundësi të reja afariste, dhe duke i sjellë ekonominë me zhvillim të shpejtë brenda një tregu të përbashkët. Tani, BE-ja është zona më e madhe ekonomike e botës. Tregu i brendshëm më i gjerë si dhe mundësitë e reja ekonomike kanë rritur prosperitetin dhe konkurrencën e evropianëve.

Shpresoj se leximi i kësaj broshure do të jetë informativ dhe i lehtë, dhe do t'iu ofrojë përgjigje pyetjeve tuaja lidhur me zgjerimin e BE-së.


Olli Rehn

Nga 6 në 27 Shtete Anëtare	4
Kush mund të bashkohet?	6
Kush vendos?	8
Procesi i zgjerimit në veprim: përmbushja e kërkesave	9
Të ndihmuarit e kandidatëve për tu përgatitur për anëtarësim	14
E ardhmja	16

Përkthimin e publikimit e realizoi:

Zyra ndërlidhëse e Komisionit Evropian

E shtypur në Kosovë*

*nën Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të KB

As Komisioni Evropian, as ndonjë person që vepron në emër të Komisionit nuk është përgjegjës për shfrytëzimin që do të mund të bëhej nga informacioni në vijim.

Një pjesë e konsiderueshme e informacionit shtesë mbi Bashkimin Evropian ndodhet në Internet. Ai mund të arrihet përmes serverit Europa (<http://europa.eu/>).

Informacioni lidhur me zgjerimin e Bashkimit Evropian mund të gjendet në faqen e internetit të Drejtoratit Gjeneral për Zgjerim (<http://ec.europa.eu/enlargement/>).

Të dhënat e katalogimit mund të gjenden në fund të këtij publikimi

ISBN-13 978-92-79-11331-4

Komisioni Evropian, Drejtorati Gjeneral për Zgjerim, 2007 © Komunitetet Evropiane 2007

Riprodhimi është i autorizuar nëse tregohet burimi.

Publikimi origjinal është shtypur në Belgjikë



Nga 6 në 27 Shtete Anëtare

Me 25 Mars 1957, liderët e gjashtë vendeve të cilat rimëkëmbeshin nga shkatërrimet e luftës, u ulën së bashku në Romë për nënshkrimin zyrtar të Traktateve të cilat eventualisht i dhanë jetë asaj që ne sot e quajmë Bashkim Evropian. Ishte një hap pa precedent, një hap që kërkonte shumë guxim dhe vizion: vendet që kishin luftuar me njëra tjetrën me shekuj, u pajtuan që të marrin vendime së bashku lidhur me çështjet që ishin qenësore për të ardhmen e tyre. Ata po ashtu ranë dakord që t'i transferonin disa prej kompetencave të tyre në nivel të ri, në atë që ne thjeshtë i referohemi si Bashkim Evropian.

BE-ja ka qenë një sukses historik. Ai ka sjellë periudhën më të gjatë të paqes së pandërprerë dhe një nivel të prosperitetit të pa krahasuar të popullit të tij. Ajo çfarë filloi si klub i të 6'tëve tani është shtëpia e 27 vendeve me një popullatë me pothuaj 500 milionë banorë.

Suksesi i BE-së është shndërruar në një magnet. Integrimi i anëtarëve të rinj ishte pjesë e planit që nga fillimi. Etërit themelues kanë qenë mjaft të sigurt në idenë e tyre për ta lënë derën e hapur për vendet e tjera evropiane për tu bashkuar. Të ndihmuarit e vendeve, dëshira e të cilave ka qenë të bëhen anëtarë, ka qenë përgjigjja e BE-së ndaj ndryshimeve në platformën politike evropiane gjatë pesë dekadave të fundit, duke promovuar rritjen ekonomike dhe solidaritetin, dhe duke përforcuar forcat demokratike në vendet e dala nga diktatura.

Bashkimi Evropian ka sjellë përparësi të mëdha për të gjithë evropianët- stabilitet, prosperitet, demokraci, të drejta të njeriut, liri themelore dhe sundim të ligjit. Këto nuk janë vetëm parime abstrakte. Ato e kanë transformuar cilësinë e jetesës të miliona njerëzve. Përfitimet nga tregu i vetëm për konsumatorët në BE janë të dukshme: rritja ekonomike dhe krijimi i vendeve të punës, produkte më të sigurta, çmime më të ulëta, dhe zgjedhje më të mëdha në sektorët vendimtarë siç janë telekomunikacioni, sektori bankar dhe transporti ajror, për t'i numëruar vetëm disa prej tyre.

Por BE nuk ka të bëjë vetëm me pasuri dhe standarde të përmirësuar të jetesës. Shumë qytetarë të BE-së ende e kujtojnë se si është të rritesh në periudhë lufte, apo nën regjim represiv, në frikë nga policia sekrete. Shumë evropianë kanë ende memorie të jetesës me frikë dhe persekutime. Shumë prej tyre janë rritur jashtë vendeve të tyre, fëmijë të politikanëve në ekzil.

BE-ja është komunitet i vlerave. Ne jemi një familje e vendeve demokratike të Evropës, të përkushtuar për të punuar së bashku për paqe, prosperitet, liri dhe drejtësi sociale. Dhe ne i mbrojmë këto vlera. Ne shikojmë që ta inkurajojmë bashkëpunimin në mes të popujve të Evropës duke e respektuar dhe ruajtur diversitetin tonë.



Zgjerimet sipas radhës

Organizata e themeluar në vitin 1957 si Komunitetet Evropiane, dhe tani e njohur si Bashkimi Evropian, fillimisht kishte 6 anëtarë: Belgjikën, Francën, Gjermaninë, Italinë, Luksemburgun dhe Holandën.

Në vitin 1973, Danimarka, Irlanda dhe Mbretëria e Bashkuar u bënë Shtete Anëtare. Greqia u bashkua me 1981, dhe Portugalia dhe Spanja pasuan me 1986. Austria, Finlanda dhe Suedia u bashkuan me 1995.

Në vitin 2004, në zgjerimin më të madh të BE-së, Qiproja, Republika Çeke, Estonia, Hungaria, Letonia, Lituania, Malta, Polonia, Sllovakia dhe Sllovenia u bënë Shtete Anëtare.

Në Janar 2007, u bashkuan Bullgaria dhe Rumania duke e rritur numrin e anëtarëve në 27.



Kush mund të anëtarësohet?

Kërkesat për anëtarësim në BE janë përcaktuar me saktësi të rritur përgjatë evoluimit të BE-së, me qëllim të ofrimit të qartësisë për qytetarët dhe për të shërbyer si udhërrëfim për vendet që dëshirojnë të bashkohen.

Neni 49 i Traktatit mbi Bashkimin Evropian thotë se çdo vend evropian mund të aplikojë për anëtarësim nëse i respekton parimet e lirisë, demokracisë, respektimit të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, si dhe sundimit të ligjit.

Një vend mund të bëhet anëtar vetëm nëse i përbush të gjitha kriteret për praninë siç janë definuar së pari nga Këshilli Evropian në Kopenhagë më 1993, dhe ri-forcuar me 1995. Këto kriterë janë:

1. **Politike:** institucione stabile që garantojnë demokraci, sundim të ligjit, të drejta të njeriut dhe respektim dhe mbrojtje të minoriteteve.
2. **Ekonomike:** një ekonomi funksionale të tregut dhe kapacitet për tu marrë me konkurrencën dhe fuqitë e tregut në BE.
3. **Kapaciteti për të ndërmarrë obligime** të anëtarësimit, përfshirë aderimin në objektivat e unionit politik, ekonomik dhe monetar
4. **Implementimi i tij përmes strukturave të përshtatshme administrative dhe gjyqësore.**

Përveç këtyre, BE-ja duhet të jetë në gjendje që të integrojë anëtarë të rinj, në mënyrë që ta rezervojë të drejtën për të vendosur se kur është i gatshëm t'i pranojë ata.

Disa vende evropiane akoma duhet ta shndërrojnë perspektivën e tyre evropiane në anëtarësim në BE. Kroacia, Turqia dhe ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë tani janë kandidatë: me Kroacinë dhe Turqinë BE-ja i ka filluar negociatat drejt anëtarësimit. Vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor - Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Serbia dhe Kosova (nën Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të KB-së) - janë po ashtu duke punuar drejt përbushjes së kërkesave për të lëvizur përpara. Shpejtësia me të cilën po avancojnë çdonjëri prej këtyre shteteve varet sidomos nga progresi i tyre drejt qëllimeve tona të përbashkëta.

Neni 6 (1) i Traktatit të Bashkimit Evropian

“Bashkimi është themeluar mbi parimet e lirisë, demokracisë, respektimit të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, dhe sundimit të ligjit, parime të cilat janë të përbashkëta për Shtetet Anëtare”.

Neni 49 i Traktatit të Bashkimit Evropian

“Çdo Shtet Evropian i cili i respekton parimet e përmendura në Nenin 6 (1) mund të aplikoj për tu bërë anëtar i Bashkimit.”



Ku qëndrojmë ne?

Turqia dhe Kroacia janë njohur nga BE si kandidatë. Negociatat e anëtarësimit me të dyja vendet janë hapur me 3 tetor 2005.

Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë është njohur si kandidatë në dhjetor 2005.

Më 2003, liderët e shteteve dhe qeverive të BE-së miratuan “Agjendën e Selanikut” duke rikonfirmuar perspektivën e anëtarësimit të ardhshëm për të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor. Si rrjedhojë, Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Serbia, dhe Kosova (nën Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të KB-së), konsiderohen si vende kandidatë potenciale



Kush vendos?

Anëtarët e rinj pranohen me pajtim unanimit të qeverive të zgjedhura në mënyrë demokratike të Shteteve Anëtare të BE-së, të cilat bashkohen ose në Këshillin e Ministrave ose në Këshillin Evropian.

Shumë para fillimit të çfarëdo negociate për pranim, të gjitha marrëveshjet në mes të vendeve të BE-së dhe cilitdo anëtarit potencial - siç janë Marrëveshjet e Stabilizim Asociimit me vendet e Ballkanit Perëndimor apo Unionit Doganor me Turqinë - arrihen vetëm pasi Shtetet Anëtare të BE-së ta kenë dhënë miratimin e tyre.

Kur një vend aplikon që t'i bashkohet BE-së, qeveritë e Shteteve Anëtare, të përfaqësuara në Këshill, vendosin - pasi ta kenë marrë një opinion nga Komisioni - se a do ta pranojnë apo jo aplikimin dhe ta njohin vendin si një kandidat. Ngjashëm, Shtetet Anëtare vendosin vetë se kur dhe në çfarë kushtesh t'i hapin

dhe mbyllin negociatat e anëtarësimit me kandidatët mbi çdo fushë të politikës. Dhe janë Shtetet Anëtare ato të cilat vendosin se kur janë negociatat e pranimit të përmblytura në mënyrë të kënaqshme.

Drafti i Traktatit të Pranimit duhet të vendoset dhe të nënshkruhet nga çdo Shtet Anëtar si dhe vendi kandidat përpara se një kandidat të bëhet një shtet i pranuar, dhe pastaj duhet të ratifikohet nga çdo Shtet Anëtar sipas procedurave të tyre të përcaktuara me kushtetutë. Parlamenti Evropian, anëtarët e të cilit zgjedhen drejtpërdrejtë nga qytetarët e BE-së, po ashtu duhet ta jap pajtimin e vet.



Procesi i zgjerimit në veprim: Përmbushja e kërkesave

Politika e zgjerimit e BE-së siguron një proces të menaxhuar mirë të anëtarësimit, në mënyrë që zgjerimi të sjellë përfitime të njëkohësishme edhe për BE-në, edhe për vendet që bashkohen. Kandidatët duhet të demonstrojnë se ata do të jenë në gjendje që ta luajnë pjesën e tyre në tërësi si anëtarë - diçka që kërkon përkrahje të gjerë në mesin e qytetarëve, si dhe pajtueshmëri politike dhe teknike me standardet dhe normat e BE-së. Përgjatë procesit, nga aplikimi e deri tek anëtarësimi, BE-ja i aplikon procedurat gjithëpërfshirëse të aprovimit fazë pas fazë.

Vendi i cili dëshiron t'i bashkohet BE-së paraqet një kërkesë për anëtarësim në Këshill, ku qeveritë e të gjitha Shteteve Anëtare të BE-së janë të përfaqësuara. Këshilli kërkon nga Komisioni që t'i vlerësojë mundësitë e aplikantit për përmbushjen e kushteve për anëtarësim. Nëse Komisioni jep një opinion pozitiv, dhe Këshilli pajtohet unanimisht për mandatin negociues, negociatat hapen në mënyrë formale në mes të kandidatit dhe të gjitha Shteteve Anëtare.

Në mënyrë që të ndihmohen vendet për anëtarësimin e ardhshëm, dizajnohet një strategji e para-anëtarësimit. Elementet kyçe të kësaj strategjie përfshijnë marrëveshjet të cilat përcaktojnë të drejta dhe obligime (si Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit në rastin e vendeve të Ballkanit Perëndimor), si dhe mekanizma të veçantë të bashkëpunimit si Partneritetet e Anëtarësimit apo Evropiane të cilat përcaktojnë objektiva konkrete të reformave të cilat duhet të arrihen nga kandidatët dhe kandidatët potencialë. Asistenca financiare e BE-së është një aspekt tjetër i rëndësishëm i strategjive të para-anëtarësimit.

Negociatat e anëtarësimit

Së pari, është me rëndësi që të nënvizohet se termi "negociata" mund të keqkuptohet. Negociatat e anëtarësimit fokusohen në kushtet dhe kohën e adoptimit, implementimit dhe aplikimit të rregullave të BE-së - rreth 90.000 faqe - nga kandidati. Dhe këto rregulla (gjithashtu të njohura si "acquis", në Frëngjisht "ajo për çka është rënë dakord") nuk janë të negociueshme. Për kandidatët, është çështje qenësore që të merren vesh se si dhe kur t'i adoptojnë dhe implementojnë rregullat dhe procedurat e BE-së. Për BE-në, është me rëndësi që të marr garancione mbi datat dhe efektshmërinë e implementimit të çdo rregulli nga kandidati.

Negociatat zhvillohen *individualisht* me çdo kandidat, dhe rrugëtimi varet nga progresi i çdo vendi në përmbushjen e këtyre kërkesave. Kandidatët si rrjedhojë kanë një motivim që t'i implementojnë reformat e duhura shpejtë dhe në mënyrë efektive. Disa prej këtyre reformave kërkojnë transformime të konsiderueshme dhe ndonjëherë të vështira të strukturave politike dhe ekonomike të vendit. Prandaj është me rëndësi që qeveritë në mënyrë të qartë dhe të bindshme t'iu komunikojnë arsyet për këto reforma qytetarëve të vendit. Përkrahja nga shoqëria civile është qenësore në këtë proces.

Negociatat e anëtarësimit zhvillohen në mes të Shteteve Anëtare të BE-së dhe vendeve candidate. Sesionet e negociatave mbahen në nivel të ministrave apo zëvendësve, p.sh. Përfaqësuesve të Përhershëm të Shteteve Anëtare, dhe Ambasadorëve apo Kryesuesve të Negociatave për vendet candidate.

Në mënyrë që të lehtësohen negociatat, i tërë ligji (acquis) i BE-së ndahet në "kapitu", ku çdonjëri korrespondon me një fushë të politikës. Hapi i parë në negociata quhet "ekzaminim" ("screening"); qëllimi i tij është që të identifikohen fusha të cilat kanë nevojë për përafrimin e legjislativioneve, institucioneve apo praktikave të vendeve candidate.

Kapitujt e Acquis

1. Lëvizja e Lirë e Mallrave
2. Liria e lëvizjes së punëtorëve
3. E drejta e vendosjes dhe liria e ofrimit të shërbimeve
4. Lëvizja e lirë e kapitalit
5. Prokurimi Publik
6. E drejta e ndërmarrjeve
7. E drejta e Pronësisë Intelektuale
8. Politika e konkurrencës
9. Shërbimet financiare
10. Shoqëria informative dhe media
11. Agrikultura
12. Siguria në ushqim, politika veterinare dhe fitosanitare
13. Peshkataria
14. Politika e transportit
15. Energjia
16. Tatimet
17. Politika ekonomike dhe monetare
18. Statistikat
19. Politika sociale dhe punësimi
20. Politika e ndërmarrjeve dhe industriale
21. Rrjetet Trans-Evropiane
22. Politika regjionale dhe koordinimi i instrumenteve strukturale
23. Gjyqësia dhe të drejtat themelore
24. Drejtësia, liria dhe siguria
25. Shkenca dhe kërkimi
26. Arsimi dhe kultura
27. Mjedisi
28. Mbrojtja e konsumatorit dhe shëndetit
29. Unioni i doganave
30. Marrëdhëniet e jashtme
31. Politikat e jashtme, të sigurisë dhe mbrojtjes
32. Kontrolli financiar
33. Dispozitat financiare dhe buxhetore
34. Institucionet
35. Çështjet tjera

Si bazë për lansimin e procesit aktual, teknik të negociatave, Komisioni përgatitë një “raport ekzaminues” për çdo kapitull dhe çdo vend. Këto raporte dorëzohen në Këshill. Komisioni është ai i cili bënë rekomandime mbi atë se a duhet të hapen negociatat mbi një kapitull, apo të kërkohet së pari përmbushja e disa kushteve (apo “standardeve”).

Vendi kandidat pastaj e dorëzon *qëndrimin negociues*. Në bazë të propozimit nga Komisioni, Këshilli e aprovon një *qëndrim të përbashkët* të BE-së ku lejon hapjen e negociatave.

Pasi që BE-ja të ketë vendosur një qëndrim të përbashkët mbi çdo kapitull të *acquis*, dhe pasi që kandidati e pranon qëndrimin e përbashkët të BE-së, negociatat mbi atë kapitull përmyllen - por vetëm përkohësisht. Negociatat e anëtarësimit në BE operojnë mbi parimin se “për asgjë nuk është rënë dakord, përderisa çdo gjë është akorduar”, kështu që përmyllja përfundimtare e kapitullit ndodhë vetëm në fund të tërë procesit të negociatave.

Raporti ekzaminues Kroaci, Kapitulli 20 - Politikat industriale dhe të ndërmarrjes

“III. Vlerësimi i shkallës së përafrimit dhe kapacitetit implementues.

Në përgjithësi, Kroacia ka arritur një nivel të kënaqshëm të përafrimit me *acquis*; ka nevojë që ta finalizojë strategjinë e vet industriale dhe ta përmirësojë kapacitetin e vlerësimit të konkurrencës industriale dhe ta përmirësoj analizën dhe formulimin e politikave [...]”



Raportimi dhe monitorimi

Komisioni e mban Këshillin dhe Parlamentin Evropian të informuar rregullisht lidhur me progresin e vendeve kandidate, përmes dokumenteve strategjike vjetore dhe raporteve të progresit individual të vendeve. Ai po ashtu monitoron përmbushjen e kërkesave standarde, dhe progresin në respektimin e hapave të ndërmarra.



Turqia, Raporti i Progresit 2006 Kapitulli 25 "Shkenca dhe Kërkimi"

"Politika kërkimore e Turqisë ka rezultuar në një buxhet të rritur në mënyrë të konsiderueshme për hulumtime dhe zhvillim: gati pesëfishi krahasuar me nivelet e vitit 2002. Janë hapur universitete të reja në 15 qytete. Përmirësimet janë arritur edhe në kapacitetet shkencore dhe kërkimore të Turqisë përfshirë dhe pjesëmarrjen e saj gradualisht të suksesshme në FP6 (Programi Kornizë i 6'të). Shkalla e suksesit të Turqisë nën FP6 është përmirësuar dhe tani është 17%. Megjithatë, është nën mesataret e BE-së për rreth 20%. Sa i përket financimit, Turqia ka qenë shpesh e suksesshme në fitimin e projekteve të vogla. Megjithatë, financimi i BE-së nuk po e arrin potencialin e vet.

Duke marrë parasysh veprimet të cilat Turqia i ka ndërmarrë në lidhje me lëvizshmërinë e hulumtuesve, shkencës dhe shoqërisë dhe 3% të GDP'së për masat e Planit të Veprimit për Shkencë dhe Teknologji, Turqia është tanimë e integruar në Zonën Evropiane Kërkimore".

Monitorimi vazhdon deri në pranim. Kjo mundëson dhënien e udhëzimeve shtesë me marrjen e përgjegjësisë të anëtarësimit nga vendet, dhe po ashtu i garanton Shteteve Anëtare se anëtarët e rinj i përmbushin kushtet e pranimit.

Traktati i Anëtarësimit

Kur negociatat mbi të gjitha kapitujt kompletohen dhe të dy palët janë të kënaqura, rezultatet inkorporohen në një projekt Traktat të Anëtarësimit. Nëse ai e fiton përkrahjen e Komisionit, Këshillit dhe Parlamentit Evropian, Traktati nënshkruhet dhe ratifikohet nga vendi kandidat dhe të gjitha Shtetet Anëtare.

Nga nënshkrimi i Traktatit të Anëtarësimit deri te anëtarësimi

Pasi që të nënshkruhet Traktati i Anëtarësimit, vendi kandidat bëhet "Shtet në pranim" ("acceding state") dhe e fiton të drejtën në disa privilegje të përkohshme deri sa të bëhet Shtet Anëtar i BE-së. Si një shtet në pranim, ai mund të komentojë mbi projekt propozimet e BE-së, komunikatat, rekomandimet apo iniciativat, dhe e fiton një "status të vëzhguesit aktiv" mbi organet dhe agjencitë e BE-së, ku ka të drejtë të flas, por jo edhe të votoj. Pasi që të kompletohet procesi i ratifikimit, Traktati i Anëtarësimit hyn në fuqi në datën e caktuar, dhe vendi bëhet Shtet Anëtar.



Të ndihmuarit e kandidatëve për tu përgatitur për anëtarësim

Progresi i vendit kandidat drejt BE-së varet nga ajo se sa mirë i implementon ai vend reformat e duhura për përmbushjen e kërkesave të anëtarësimit. BE-ja ofron përkrahje për vendet në përgatitjet e tyre për anëtarësim në BE.

Lidhjet formale të vendeve candidate në BE mund të vendosen përmes marrëveshjeve të ndryshme. Për shembull, lidhjet formale të Turqisë me BE-në janë përcaktuar në një marrëveshje të nënshkruar së pari më 1963 ("Marrëveshja e Ankarasë"), e cila është azhurnuar rregullisht që nga atëherë, dhe në Unionin e Doganave të vendosur me 1995.

Për vendet e Ballkanit Perëndimor, është përcaktuar një proces i veçantë në vitin 2000, i quajtur *Procesi i Stabilizim-Asociimit* (PSA). PSA ndjek tri qëllime: stabilizimin dhe tranzicionin e lehtë në ekonomi të tregut, promovimin e bashkëpunimit regional dhe prospektin e anëtarësimit në BE. Ai i ndihmon vendet e regjionit që t'i ndërtojnë kapacitetet e tyre për adoptimin dhe implementimin e standardeve evropiane. Në kuadër të PSA, Unioni i ofron vendeve të Ballkanit Perëndimor koncesione tregtare, marrëdhënie kontraktuale dhe asistencë ekonomike dhe financiare. Që nga viti 1991, BE-ja ka ofruar rreth €12 miliardë si asistencë për Ballkanin Perëndimor, asistencë më e madhe për kokë të banorit në botë.

Vendet candidate shpesh kanë nevojë për të bërë reforma të konsiderueshme për tu siguruar se rregullat e BE-së jo vetëm që adoptohen, por edhe implementohen në mënyrë të duhur. Atyre mund t'iu duhet



Kroacia

që të themelojnë organe, siç është një autoritet i paruarur i konkurrencës, apo agjencia për standardet e ushqimit. Apo atyre do të mund t'iu duhet t'i rristrukturojnë institucionet ekzistuese: demilitarizimi i policisë, përmirësimi i mbrojtjes së mjedisit dhe sigurisë nukleare, apo më shumë autonomi për prokurorët në luftën kundër korrupsionit.

Këto reforma zakonisht përfshijnë investime të mëdha në njohuri dhe fonde. BE-ja ofron një gamë të programeve dhe mekanizmeve plotësues për të ofruar asistencë financiare dhe teknike në zhvillimin e këtyre reformave. Duke qenë të vetëdijshëm për sfidat të cilat mund t'i paraqesin reformat për qytetarët në vendet candidate, BE-ja po ashtu promovon edhe strategji për ta përmirësuar të kuptuarit e publikut për procesin e anëtarësimit, përfshirë dialogun në mes të vendeve të BE-së dhe vendeve candidate në nivel të shoqërisë civile: unionet tregtare, asociacionet e konsumatorëve dhe organizatat e tjera jo qeveritare.

Një aspekt i rëndësishëm i asistencës së BE-së është përforsimi i kapacitetit institucional, apo "ndërtimi institucional", duke zhvilluar strukturat apo duke trajnuar personelin përgjegjës për aplikimin e rregullave të BE-së në vendet candidate. Këshillimi mbi implementimin e acquis shpesh ofrohet përmes marrëveshjeve të "binjakëzimit" ('twinning'), ku ekspertët caktohen nga Shtetet Anëtare të BE-së, apo përmes punëtorive afat-shkurtëra.

Përgatitja e vendeve për anëtarësim mund po ashtu të nënkuptojë ofrimin e ndihmës në përmirësimin e infrastrukturës: ndërtimi i plantacioneve të mbeturinave solide, apo përmirësimi i rrjeteve të transportit. Vendet candidate lejohen të marrin pjesë në programet e BE-së, për shembull në fushat e shëndetit publik apo hulumtimit, dhe po ashtu mund të marrin grante dhe kredi nga institucionet ndërkombëtare financiare. Kjo përvojë iu mundëson vendeve candidate të mësojnë se si t'i menaxhojnë këto fonde në të cilat kanë të drejtë pas pranimit, dhe po ashtu iu ndihmon atyre të familjarizohen me politikat dhe instrumentet e BE-së.

BE-ja ka krijuar një instrument të ri financiar për ta financuar asistencën e vet në vendet që janë në rrugë drejt anëtarësimit, përfshirë një gamë të stimulimeve dhe kushteve për ta siguruar përdorimin më të mirë të parave të BE-së. Ky "Instrument i Asistencës së Para-Anëtarësimit" (IPA), që është në fuqi që nga 1 janari 2007, është një thjeshtësim i një sërë programeve të mëparshme të përkrahjes së BE-së, siç janë Phare, CARDS apo SAPARD.

Në veçanti, IPA do të ndihmojë në forcimin e institucioneve demokratike dhe sundimin e ligjit, reformimin e administratës publike, zhvillimin e reformave

ekonomike, promovimin e respektimit për të drejtat e njeriut dhe të minoriteteve, barazinë gjinore, do të përkrah zhvillimin e shoqërisë civile dhe avancimit të bashkëpunimit regional, dhe do të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm dhe zvogëlimin e varfërisë. Për vendet candidate, objektiva shtesë është adoptimi dhe implementimi i kushteve të plota për anëtarësim.

IPA do të ofrojë €11,468 milionë në çmimet aktuale mes 2007-2013, me alokime precize të vendosura në baza vjetore.



Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë

Korniza Indikative Financiare për Instrumentin e Asistencës së Para-Anëtarësimit deri në 2012 (€ milion, çmimet aktuale)

	2007	2008	2009	2010
Turqia	497.2	538.7	566.4	653.7
Kroacia	138.5	146.0	151.2	154.2
Ish Rrepublika e Maqedonisë	58.5	70.2	81.8	92.3
Sërbia	186.7	190.9	194.8	198.7
Mali i Zi	31.4	32.6	33.3	34.0
Kosova (nën rezolutë UNSCR 1244)	68.3	64.7	66.1	67.3
Bosnja dhe Hercegovina	62.1	74.8	89.1	106.0
Shqipëria	61.0	70.7	81.2	93.2
Totali	1260.2	1383.3	1480.4	1621.7



Turqia

E ardhmja

Zgjerimet e ardhshme kanë të bëjnë me vendet e Evropës juglindore. Promovimi i transformimeve demokratike në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë, dhe konsolidimi i stabilitetit është në interesin më të mirë të tërës Evropës.

Në dhjetor 2006, Këshilli Evropian e ka ripërtërirë konsensusin e tij mbi zgjerimin. BE-ja i ka konsideruar shqetësimet e qytetarëve të vet lidhur me rrugëtimin e zgjerimit në mënyrë serioze. Politika e zgjerimit është e bazuar në konsolidimin. Kjo nënkupton se BE-ja i çmon përkushtimet ekzistuese karshi vendeve që tanimë janë në proces, por është i kujdesshëm në marrjen e përkushtimeve të reja. Kushtëzimi rigoroz aplikohet në të gjitha vendet kandidatë dhe kandidatë potenciale. Datat e tyre të mundshme të pranimit varen nga progresi i tyre me reformat politike dhe ekonomike, si dhe pajtueshmëria me legjislacionin e BE-së. Çdo vend duhet të gjykohet bazuar në meritat e veta.



Në mënyrë që zgjerimi të jetë i suksesshëm, është qenësore që të sigurohet përkrahja e qytetarëve edhe në Shtetet Anëtare të BE-së edhe në vendet kandidatë dhe kandidatë potenciale. Është me rëndësi që të komunikohen më mirë suksesi dhe sfidat e zgjerimit, në mënyrë që të fitohet përkrahja e publikut dhe ta bëjnë të gjithë së bashku projektin e përbashkët që të rritet.

Pranimi i Bullgarisë dhe Rumanisë në janar 2007 e ka kompletuar raundin e pestë të zgjerimit të BE-së, i cili ka filluar në 2004 dhe e ka rritur numrin e Shteteve Anëtare të BE-së nga 15 në 27. Nuk ka ndonjë valë të ngjashme të zgjerimit të madh në ndonjë të ardhme të parashikuar. BE-ja duhet të vazhdojë të rritet sipas ritmit të përcaktuar nga qytetarët e vet dhe progresi i vendeve kandidatë në përmbushjen e kërkesave.

Natyra e Bashkimit Evropian është dinamike. Shumë është arritur gjatë viteve të kaluara, dhe rrugëtimi vazhdon. Bashkimi është i përkushtuar që t'i mbajë negociatat në binarë. Në procesin e integritit të anëtarëve të rinj, ne do të punojmë së bashku drejt rritjes së prosperitetit dhe sigurisë duke e përmirësuar solidaritetin.

Edhe BE edhe vendet e përfshira përfitojnë nga kompetencat e transformuara të procesit që çon në anëtarësim.

Historiku i zgjerimit

- 1957 Belgjika, Franca, Gjermania, Italia, Luksemburgu dhe Holanda nënshkruan Traktatin e Romës dhe themeluan Komunitetin Ekonomik Evropian (KEE).
- 1963 U nënshkrua Marrëveshja e Ankarasë me Turqinë.
- 1973 Danimarka, Irlanda dhe Mbretëria e Bashkuar iu bashkuan KE-së.
- 1981 Greqia iu bashkua KE-së.
- 1986 Spanja dhe Portugalia iu bashkuan KE-së.
- 1987 Turqia aplikoi t'i bashkohet KE-së.
- 1990 Integrimi i ish-Republikës Demokratike të Gjermanisë pas ri-unifikimit të Gjermanisë.
- 1993 Këshilli Evropian i Kopenhagës vendosi kriteret e anëtarësimit.
- 1995 Austria, Finlanda dhe Suedia iu bashkuan KE-së. Unioni i Doganave me Turqinë.
- 1999 Këshilli Evropian i Helsinkit e konfirmoi Turqinë si vend kandidat.
- 2000 Samiti i Zagrebit e konfirmoi përkushtimin e plotë për Procesin e Stabilizim-Asociimit nga vendet e Ballkanit Perëndimor.
- 2003 Kroacia aplikoi për anëtarësim në BE. Samiti i Selanikut i riafirmoi përkushtimet e BE-së në integrimin eventual në Bashkim të vendeve të Ballkanit Perëndimor.
- 2004 Qiproja, Republika Çeke, Estonia, Hungaria, Letonia, Lituania, Malta, Polonia, Sllovakia dhe Sllovenia iu bashkuan BE-së. Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë aplikon për t'iu bashkuar BE-së.
- 2005 Hapja e negociatave të anëtarësimit me Turqinë dhe Kroacinë. Ekzaminimi fillon për Turqinë dhe Kroacinë.
- 2006 Hapja dhe përmbyllja e përkohshme e kapitullit të parë të negociatave me Kroacinë dhe Turqinë.
- 2007 Janar: Bullgaria dhe Rumania u bënë Shtete Anëtare të BE-së.

Komisioni Evropian – Drejtorati i përgjithshëm për zgjerim

Të kuptuarit e zgjerimit – Politika e zgjerimit e Bashkimit Evropian

Luksemburg: Zyra e publikimeve zyrtare të Komuniteteve Evropiane

2007 – 17 fq. – 17, 4 x 24, 9 cm

ISBN: 978- 92 – 79- 11331- 4

Numri i katalogimit: JU – 78 – 07 – 352 – SQ – C

Më shumë informata mbi zgjerimin do të gjeni në faqen e internetit të Drejtoratit Gjeneral për Zgjerim të Komisionit Evropian.

<http://ec.europa.eu/enlargement/>

JU - 78 - 07-352 - SQ - C

Komisioni Evropian-Drejtorati Gjeneral për Njësinë e Zgjerimit A2: Zyra e Informacionit dhe Komunikimit. Adresa e Zyrës: Rue de la Loi 200, B-1049 Bruksel Tel: (+32-2) 299.06.66 Fax: (+32-2) 299.17.77

Për informacione për çfarëdo aspekti të politikave të BE-së telefononi Evropën Direkt nga çdo vend në BE: 00800 6 7 8 9 10 11



Zyra e Publikimeve
Publications.europa.eu

ISBN 978-92-79-11331-4



9 789279 113314